

SHOQËRIA “SANDSTONE ALBANIA ” SHPK

NIPT: M314200171

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

**OBJEKTI I RANORËVE SILICORË “ZOGAS” BERAT
(ZONA MINERARE KONKURUESE NR 22/44)**

Shtator 2023

PERMBAJTIA

A) Një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;	Error! Bookmark
B) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;	4
C) Një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër.	5
Ç) Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;	7
D) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;	8
Dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;	9
E) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;	9
Ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;	11
Lloji i ndikimit	Error! Bookmark not defined.
F) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).	12



A) Një përshkrim të shkurtër të mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, të shoqëruar dhe me imazhe të marra jo më vonë se 6 muaj nga data e aplikimit;

Objekti ranorit silicor Zogas, Skrapar, Qarku Berat, shpallur zonë minerare konkurruese Nr 22/44, ndodhet në teritorin e Bashkisë Skrapar, Qarku Berat.

I gjithë teritori i Bashkisë Skrapar, përfshi dhe objektin e ranorit silicor Zogas, karakterizohet nga reliev kodrinor fushor me rënije të butë. Ky teritor është i populluar nga fshatra në të cilët popullsia vjen gjithnjë duke u reduktuar për shkak të lëvizjeve brënda dhe jasht vendit.

Nga ana fiziko-gjeografike territori i kësaj njësie paraqet disa forma fushore dhe kodrinore të relievit.

Nga pikpamja gjeografike terreni ku shtrihet objekti që kerkohet për shfrytëzim, është terren kodrinoro-malor. Zona e kerkuar për prodhimin e ranorit pllakore ndodhet rreth 30-60m në majte të rrugës së makines që zhvillohet përgjatë shpatit të perroit të Zogazit

Ne Jug –Lindje zonë shoqërohet gjatë gjithë gjatësisë së saj me rrugën e makines ekzisuese, e cila zhvillohet edhe përtej zonës.

Vetë terreni ku kerkohet leja minerare është i pak aksidentuar dhe shumë i shpelare nga erozioni. Në sipërfaqe vihen re proska të vogla të cilat në shumicën e kohës janë të thata . Thellessia e prerjeve erozionale të krijuara nga gryerjet nuk është e konsiderueshme

Kuota e poshtme e zonës së kerkuar për shfrytëzim është + 540 m ajo e sipërme + 590m

Nga pikpamja topografike objekti ka formën e një strukture gati monoklinale me pak përdredhje që ka një shtrirje të përgjithshme me azimut 65° - 70° -JL VP dhe me rënie Jugelindore me azimut rënie + 160° m dhe kënd rënie të terrenit 18-23 gradë.

Përsa i përket mbulesës bimore në sipërfaqen ku do të zbatohet projekti, vërejmë se ajo takohet vënde vënde, duke krijuar një raport pozitiv në drejtim të mungesës së bimësisë me bimësinë që ka .

Aty takohen barëra të ndryshme, ferra, shkurre, gjëmbaç dhe bimë të tjera të egra, mungojnë drurët frutorë si dhe nuk janë kultivuar asnjëherë drithëra,

Vendi ku ndodhet zona minerare është pothuajse i zhveshur nga bimesia. Rriten vetëm pak shkurre të vogla lisi. Në zonën e dherave (mbulesës që nuk përfaqëson rezervë gjeologjike) rriten lule dhe barishte karakteristike të zonës. Në pjesën mbi zonën e shfrytëzimit rritet çaji i malit, që është karakteristik për këtë zonë .





Pamje e zones ku ndodhet objekti minerare 22/44

B) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj;

Objekti gjeografikisht perfaqeson nje strukture monoklinale ne formen e nje shpati plotesisht te drenuar. Per shkak te kushteve gjeologjike vete zona e objekti qe drenon ne shtrat perroi nuk ka permbajtje ujrash ne te, me perjashtim te ndonje sasive te vogel ne kuotat e poshteme .

Nga pikpamja hidrogafike, prane objektit kalon perroi zezonali i Zogasit . Prurjet e tij ndryshojne ne varesi te stineve. Ne stinen e veres ne te pothuajse nuk ka uje ose sasi e tyre eshte e vogel dhe nuk paraqet ndonje veshtiresi gjate shfrytezimit. Ne stinen e dimrit, te shkrirjes se bores ose te rreshjeve te ndryshme ne forme shiu, per shkak te siperfaqes se ujembledhesit, qe derdhet ne kete perrua, prurjet maksimale te matura ne te jane te rendit te 0.5-1.2 m³/sekonde. Keto sasira ujrash jane shume te perkoheshme dhe ne nje interval kohe qe nuk e kalon 2-3 ore.

Prania e ujrave te rreshjeve te shiut nuk veshtiresojne kushtet teknike te shfrytezimit te objektit pasi ato parashikohet te rrjedhin ne drejtim te perroit qe pershkron zonen e shfrytezimit dhe e ndan ate ne dy pjese.

Pjeresia e shesheve te punes ne karriere prej 2-6 o/oo parshikohet te jete e tille qe te mundesoje rrjedhjen normale ne drejtim natyral te ujrave te rreshjeve

Rreshjet e ndryshme te dendura do te veshtiresojne kryesisht transportin e materialit te prodhuar ne karriere, i cili per arsye te tyre mund te nderpritet per intervale te kufizuar kohe .

Persa i perket kryerjes se proceseve teknologjike te rrezim-shkeptjes se materialit dhe blloqeve gjate shfrytezimit te karrieres, ndikimi i rreshjeve do te jete relativisht i kufizuar me perjashtim te diteve me temperatura te ulta dhe ngricave.




Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku kerkohet leja minerare nuk ka prroska. Kur ka reshje, neper te rrjedhin me rrembim ujra siperfaqesore per shkak dhe te pjerresise mjaft te madhe te terrenit.

Rajoni ku ndodhet zona minerare konkuruese 22/44 Zogasi, pershkohet nga Lumi Osum, I cili eshte degë kryesore e Lumit Seman. Eshte quajtur me pare **Lumi i Beratit**. Ai eshte 161 km i gjate, sipërfaqja ujëmbledhëse është 2.150 km², lartësia mesatare 828 m, prurja mesatare shumëvjeçare 32,5 m³/s dhe rrjedhje të pakta prej 17,5 l/s/km². Uji ka mineralizim mesatar prej 345 mg/l.

Osumi kalon në zemër të qytetit të Beratit. Në fund të rrjedhës së tij bashkohet me lumin Devoll ku bashkë krijojnë lumin Seman/

Lumi Osum kalon në jug të zonës minerare konkuruese rreth 1.3 km larg duke ardhur nga lindja dhe duke u ngritur në drejtim të veri perëndimit, për tu futur në teritorin e qytetit të Çorrovodës e për të vazhduar drejt perëndimit për në qytetin e Beratit.

Ujrat e lumit Osum janë të sasive të konsiderueshme deri të mëdha dhe kanë forcë dinamike e cila duke vepruar në shtratin e tij e ka thelluar atë. Nga ky fenomen përgjatë shtratit të lumit janë krijuar kanione të cilat kanë vlera të pa llogaritshme si përsa i përket mjedisit ashtu dhe nga ana turistike.



Pamje nga lumi Osum

C) Një identifikim të ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër.

Çdo veprimtari që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme.



Veprimtaria minerare dhe zhvillimi i saj, janë shume të rëndesishme ne eknomine e nje vendi. Nga ana tjetër veprimtaritë shoqerohen edhe me ndikime mjedisore negative te cilat ne disa raste mund te jene te pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative mjedisore mund te minimizohen permes nje planifikimi te kujdesshem mjedisor dhe aplikimit te teknikave dhe teknologjise se parandalimit te ndotjeve.

Vleresimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e veprimtarise behet duke u nisur nga nje sere faktoresh qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e operimit, sasine e energjise, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjenerura, te gjitha keto ne kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Kur flasim per shfrytezim te resurseve minerare duhet te marrim ne konsiderate edhe perdorimin e makinerive te renda, te eksploziveve si dhe zhvendosjen e transportin e sasive te medha te mineralit nga mbitoka e nentoka.

Bazuar ne menyren e propozuar per shfrytezim ndikimet me thelbesore mund dhe duhet te analizohen sipas fazave te veprimtarise

Nga funksionimi i ketij aktiviteti, nuk ka dhe nuk vleresohen ndikime negative ne biodiversitet, mjedisin biologjik tokesor, mjedisin social-ekonomik, qe shkaktojne ndryshimet klimatike, ndikimet nderkufitare e tjere.

Ndikimet negative të zbatimit të projektit lidhen direkt me sipërfaqen e zones minerare, me sipërfaqen e prekur nga punimet e hapjes dhe shfrytëzimit dhe me sipërfaqen e vend depozitimit të mbetjeve minerare.

1- Shqetesim i faunes ne zone

Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mbrohet me status te veçante. Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nga shfrytezimi, nga shfrytëzimi preket vetëm sipërfaqja e zones minerare, megjithsëe ajo eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia. Për të mbrotur faunën e zones, shoferet do te udhezohen te bejne kujdes gjate transportit per te mos dëmtuar atë.

Një ndër masat është dhe ajo që shoferet kur takojnë përfaqesue të faunës në rrugë, duhet ti spostojne ato pastaj te vijojne udhetimin.

2- Ndikime ne pejsazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti

Nder ndikimet me evidente do të jenë ndryshime në peisazh dhe relief ose topografinë e zones, për shkak të hapjes së karruierës dhe shfrytëzimit të saj, sepse do të kemi spostime apo heqje të sasirave të konsiderueshme të argjilës.

Shoqëria ka hartuar një plan rehabilitimi i cili konsiston ne ruajtjen e siperfaqes së tokes nga erozioni gjatë hapjes apo kryerjes së punimeve.

3- Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer

a- Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet

Sasia e gazeve NO₂ dhe SO₂ qe do te shkarkohet eshte brënda standartit të lejuar sepse mjetet e hapjes, rrëzimit dhe ngarkim transportit janë objekt i kontrollit teknik dhe nëse vërehen defekte ato do të riparohen menjëherë.



b- Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes.

Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe.

c-Sasi pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit. Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojte kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle

Ndotja ne toke.

Persa i perket ndotjes se tokes ajo ne kete karriere mund te jete aksidentale nga derdhja e karburanteve qe perdorin makinat dhe mjetet e germimit. Ne karriere mjetet qe do te perdoren duhen te kontrollohen here pas here per rrjedhje te karburantetit dhe vajrave dhe te eliminohen ato. Toka e germuar si sterile do te grumbullohet ne sheshin e depozitimit te sterileve te caktuar ne harten e hapjes se karrieres me siperfaqe. Ne kete shesh duhet mbrojtur me kanale periferik te cilet bejne mbrojtjen nga erozionit te materjalit te germuar. Germimi i tokes nuk do te ndote ambjentin sepse nuk clirohet asnje lloj gazi.

Ndotja ne ujra. Ne vendburim nuk parashikojme te dalin ujra. Kurse ne siperfaqe ku do te zhvillohet aktiviteti mund te kete ndotje te derdhjeve pa dashje te vajrave dhe karburantet e automjeteve.

Ç) Një përshkrim të shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimin e mbetjeve;

Aktivitetet qe zhvillohen ne mjedis shoqerohen me pasoja dhe ndikime ne mjedis qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni te kryer, sidomos mbi burimet natyrore te parinovueshme.

Industria minerare eshte pjesë shume e rendesishme ne eknomine e nje vendi, por ajo shoqerohet edhe me ndikime mjedisore negative te cilat ne disa raste mund te jene te pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative mjedisore mund te minimizohen permes nje planifikimi te kujdesshem mjedisor dhe aplikimit te teknikave dhe teknologjise se parandalimit te ndotjeve.

Ujrat e ndotur.

Sic eshte trajtuar dhe me lart, brenda zones te lejuar per shfrytezim dhe fronteve te punes nuk ka ujra siperfaqeso apo ujra nentokesor. Kurse ne siperfaqe ku do te zhvillohet aktiviteti mund te kete ndotje te derdhjeve pa dashje te vajrave dhe karburantet e automjeteve. Perdorimi i ujit ne kete objekt do te jete vete gjate muajeve te veres per lagien e territorit dhe minimizimin e sasive te pluhurit ne atmosfere



Gazet

Në nxjerrjen me karrierë të ranorit silicor, referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosfere, Gazet prej mjeteve të punës janë në intervale kohore të shkurtra, brenda normave të lejuara pa ndonjë ndikim negativ në mjedisin përreth. Këto lloje mjeteve emetojnë sasi të cilat janë rezultat i punës së motorrave me djegie të brendshme, brenda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontrolleve teknike vecanërisht për emetimet e gazta.

Pluhuri

Operacionet e punës mund të gjenerojnë një sasi të konsiderueshme pluhuri çdo ditë, si rezultat i proceseve të prerjes të bllokut dhe automjeteve që udhëtojnë rreth zonës. Në varësi të përbërjes së gurit, mund të gjendet në grimcat e ajrit, duke buruar nga vetë guri. Për të lehtësuar ekspozimin ndaj grimcave të ajrit, rekomandohet përdorimi i procesit të lagësht për të zvogëluar pluhurin e ajrit. Në varësi të klimës, lagështimi i rrugës etj duhet të bëhet lagje e rrugëve të aksesit dhe ambienteve të punës me një bot ujë që duhet të jetë gjithmonë prezent në kantier.

Zhumra Zhurmat e mundshme nga teknologjia e përdorur. Burimet e zhurmave janë në sipërfaqe. Cdo burim përhap vlerë zhurmë. Fusha akustike që rezultojnë varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimit të të gjitha pengesave ekzistuese, ndërmjet burimit dhe receptorit. Energjia zvogëlohet për gjatë rrugës si rezultat i absorbimit të sipërfaqeve, divergjencës gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Prodhimi i mbetjeve

Mbetjet ngurta, janë mbetjet minerare të cilat vijnë si rezultat i zbulimit të argjilës. Ato janë pjesë përbërëse e shkëmbinjeve rrethues, pra kanë të njëjtat veti fiziko mekanike si shkëmbinjtë që formojnë zonën.

Nisur nga fakti që përberja kimike e mbetjeve minerare është e tillë që nuk ka elemente të demshme për detimin e mjedisit, bëjnë të mundur që të mos kemi probleme me banorët e komunitetit që banojnë në largësi të konsiderueshme nga objekti. Sasia e mbetjeve minerare (dheut) do të sistemohet në sheshin e depozitimit dhe të përdoret për qëllime rehabilitimi në fazën e ndryshme të shfrytëzimit ose për rehabilitimin e sipërfaqeve të demtuara në thellësi të shfrytëzimit të minierës. Do të përkthehen dhe hapen kanalet e drenazhimit në sipërfaqe.

Masat parandaluese për minimizimin e efektit të mbetjeve minerare dhe shkarkimeve.

D) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;

Ndikimet negative të identifikuar më lart do të jenë gjatë gjithë kohës së zhvillimit të kësaj aktiviteti. Ato mund të jenë më të dukshme gjatë stinës së verës pasi edhe mundësia e shkarkimeve në këtë periudhë është më e madhe. Megjithatë duhet theksuar se proceset e



punes jane ne nje kohezgjatje jo te madhe dhe shkarkimet ne mjedis jane minimale. Pasi të rehabilitohet mjedisi nuk do të ketë ndikim negative të aktivitetit minerar.

Dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

Siperfaqja ku do te kryhen punimet per hapjen e karrierës dhe punimet e shfrytezimit eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit, do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe.

Sasia e gazeve NO₂ dhe SO₂ qe do te shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara do te jete e limituar ne kohe dhe nuk do te kete ndikime ne banoret e zones perreth.

Sa më sipër shtrirja e mundshme hapësinore e ndikimeve negative do të jetë brenda zones minerare 22/44 duke mos i kaluar kufijt e saj.

E) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të sipërfaqes së mjedisit të ndikuar në gjendjen e mëparshme, përfshirë edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

Rehabilitimi i mjedisit do të bëhet krahas nxjerrjes së mineralit të ranorit silicor, dmth do të kemi rehabilitim progresiv të sipërfaqeve të prekura dhe të objektit në tërësi.

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me 30 cm dhe' (toke) te pasur me pleh. Nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese te faqes se pjerrret do te behet me trungje te ngulura ne toke me thellesi mbi 30 cm, dhe mulcirimi do te jete i thate dhe me kashte, gjrthe te bimeve te zones dhe dege. Mulcirimi do te sherbeje, si per uljen e humbjeve te farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodikpersakohe vegjetacioni eshte i pazhvilluar mire.

Mbjelljet do te kene renditjen me largesi fidanesh çdo 8 metra, gje qe do ti jape nje kurore dendesi mjaft te mire teritorit pas shfrytezimit, dhe lejon dritesimin per veterritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

Kombinimi i punimeve te shfrytezimit te karrierës me ato te zbutjes se impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do te kete si pasoje edhe rritjen e numrit te te punesuarve.

Kujdesi per punimet rehabilituese nga ana e shoqerise do te vazhdoje deri ne mbarimin perfundimtar te shfrytezimit te karrieres dhe rehabilitimin e plotë të saj.



Duke konsideruar sipërfaqet e shesheve që zene punimet e projektuara, në tabelen e mëposhteme jepen shpenzimet e rehabilitimit, bazuar në preventivin e planit të rehabilitimit për shfrytëzim me sipërfaqe, karrierë:

Tabela e llogaritjes së vlerës së rehabilitimit

Preventivi i planit te rehabilitimit te pjeses se minieres te shfrytezuuar me siperfaqe								
Nr	Operacionet	Siperfaqja	Norma	Siperfaqe	norma	Volumi i punes	Çmimi	Vlera
			ha/ha	operacionale	m3/ha oper	m3	Leke/m3	Leke
I	Plani I mbylljes se Karrieres							
Nr	Emertimi							
a	Krehje sistemim ifaqeve anesore	1	1.5	1.5	200	300	50	15000
	Shuma I .							15000
II	Plani I menaxhimit te mbetjeve							
a	Sistemimi I mbetjeve te zbulimit	1	0.6	0.6	2000	1200	20	24000
b	Sistemimi I mbetjeve teknologjike	1	0.25	0.25	2000	2000	20	40000
	Shuma II							64000
II I	Plani i rehabilitimit perfundimtar te mjedisit							
					nr/ha	nr		
a	Mbushje me dhe e siperfaqes	1	0.5	0.5	2500	1250	35	43750
b	Mbjellje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	100	15000
c	Hapje gropash	1	0.5	0.5	300	150	1000	150000
d	Blerje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	50	75000
e	Sherbime	1	0.5	0.5	300	150	50	75000
f	Kanali I ujrave te larta		Norma		gjatesi	Volumi	Çmimi	Vlera
			ml/ha		ml	m3	leke/m3	leke
		1	300		300	75	200	15000
g	Sinjalistike							5000
	Shuma (a-g)							322750

Siperfaqet e zones qe do te preken nga shfrytezimi jane si meposhte:

- | | | |
|--|------------------------|-------------|
| 1-Siperficia e totale e prekur nga shfrytezimi | = 51472 m ² | ose 5.1 Ha |
| 2-Siperfaqia e shesh depozitimit | = 1100 m ² | ose 0.11 Ha |
| 3-Siperfaqia totale e prekur nga rrugët | = 2602 m ² | ose 0.2 Ha |



Shpenzimet per rehabilitimin e karieres do te jene = $5.41 \text{ ha} \times 322750 \text{ lek/ha} = 1746078 \text{ lek}$
Vlera totale e garancise financiare per rehabilitimin e mjedisit do te jete: = **69843.1 lekë**

Ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis Masat per mbrojtjen e tokes

Ne pergatitjen e programit te monitorimit eshte menduar qe te perzgjidhen per t'u monitoruar nga vete kompania ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (ARM). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne ARM-ne e qarkut sa here te kerkohet, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve. Me poshte jepen disa indikatore te cilet duhen monitoruar per te vleresuar suksesin dhe matur realizimin e objektiveve mjedisore te projektit. Interpretimi i nje gjendje te caktuar mjedisore duhet bere ne lidhje te ngushte me fazen ne te cilen gjendet zbatimi i projektit. Duhet kuptuar se nje gjendje e perkeqesuar e mjedisit ne nje faze te caktuar te zbatimit e cila eshte faze tranzitore dhe jo tregues absolut i realizimit te objektiveve te projektit.

Elementet e monitorimit te veprimtarise

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1.	Monitorim i zhurmave dhe pasojave te plasjeve ne miniere	Vazhdueshem
2.	Monitorimi i biodiversitetit ne zonen rreth objektit te shfrytezimit	Vazhdueshem
3.	Monitorimi i pluhurave ne objekt dhe gjate transportit	Gjate stines se thate
4.	Monitorimi i gjendje se mekanikes dhe mundesise per rrjedhje dhe ndotje.	Vazhdueshem
5.	Monitorim i faktoreve qe shkaktojne rreziqe natyrore dhe humane	Vazhdueshem

Efikasiteti i masave te Planit te Menaxhimit do te vleresohet nga rezultatet e tij konkrete ne terren nepermjet monitorimit te vazhdueshem. Plani i Menaxhimit do te permiresohet dhe pershtetet ne te ardhmen ne varesi te kerkesave praktike.

Subjekti do te kujdeset per administrimin e çdo informacioni qe lidhet me ushtrimin e veprimtarise. Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem per menyren e operimit te subjektit dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e çdo mase te parashikuar per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi. Per mbajtjen e te dhenave do te perpilohet nje regjister i veçante, fushat e te cilit te mbulojne te gjithë llojin e informacionit te mbledhur qe lidhet me aktivitetin e minieres.

a) Plani dhe masat per rehabilitimin e mjedisit

Per rehabilitimin e siperfaqes qe do te shfrytezohet, rehabilitim shoqeria do te marre disa masa tekniko organizative dhe ka planifikuar te shpenzoje ne çdo vit 69843.1 lekë. Me te detajuar keto leke do te shpenzohen bazuar ne masa per rehabilitimin e mjedisit si me poshte:

Masat per rehabilitimin e objektit hap pas hapi, krahas shfrytezimit konsistijne ne:

- Krijimin e siperfaqeve per mbledhje;



- Sistemimin e materialit te mbuleses te depozituar paraprakisht ne kufijte e karrieres;

Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve ne ajer, si pluhurat dhe zhurma, si dhe uljen e efekteve negative hapesinoredhe ne teritor ne faunen dhe floren. Per pikesynimi kryesor i studimit mbetet reabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

Masat konkrete qe do te merren gjate punimeve do te jene:

- Mbjellje me fidana akacie, pishe, gjineshtër e gjithë periferise me te larte te shpatit te territorit gjate shfrytezimit. Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrise mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e lartme dhe shpatin tjetër te kodres.
- Uljen e tensionit te shfrytezimit per stinen e veres duke evituar keshtu me sa te jete e mundur erozionin dhe pluhurat. Nga ana tjetër per te ulur efektet erodike, gjate periudhave te thata do te perdoret lagja e terreneve nen pune dhe sidomos, lagia e vendburimit te materialit te nxjere. Kjo do te evitoje edhe ndotjen gjate transportit (materiali i thate krijon pluhura).

Keto masa mund te sherbejne si bariera per pluhurin qe mund te nxirret nga aktiviteti eolik gjate shfrytezimit.

Rehabilitimi i territorit

Masat rehabilituese do te konsistojne ne:

- Uljen e erozionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore
- Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese te territorit qe do te shfrytezohet.

Se pari shfrytezimi me tarace me lartesi 6 m, eshte bere per te lehtesuar zbatimin e planit te rehabilitimit. Keto taraca do te lejojne si mbulimin e siperfaqes me gjelberim ashtu edhe evitimin e pamjeve te pakendshme te shpateve vertikale te tarracave qe mund te mbeten zbuluar ne rastet e lartesis se pergjithshme te tarraces rreth 10 m.

Rradha e mbjelljeve do te jete nga lart poshte, duke lejuar mundesine per vetepërhapjen e specieve mbi bazat e aktivitetit eolitik dhe forces se rendeses. Gjeresia e shkalles se taraces do te jete 4 m. Kjo lloj mbjellje lejon vetepërhapjen e species, si dhe nuk demton ne rritjen e bimeve pasi nuk pengon dritezimin.

F) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkuftar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Vetë vend ndodhja e objektit në Bashkinë Skrapar, Qarku Berat, shmang kontakte me kufinj të shtetror, si dhe proceset teknologjike që do të zbatohen në këtë object përjashtojnë ndikimin ndërkuftar.



Subjekti do te kujdeset per administrimin e çdo informacioni qe lidhet me ushtrimin e veprimtarise, ai do të mbajë lidhje të vazhdueshme me ARM Fier

Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem per menyren e operimit te subjektit dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e çdo mase te parashikuar per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi. Per mbajtjen e te dhenave do te perpilohet nje regjister i veçante, fushat e te cilit te mbulojne te gjithë llojin e informacionit te mbledhur qe lidhet me aktivitetin e minieres.

HARTOI : INNOVATION DEVELOPMENT ENGINEERING .SH.P.K.

EKSPERT MJEDISOR :
EKSPERT MJEDISOR :
GJEOINXHINIER :
GJEOINXHINIER :
GJEOLG :

BARDHYL SHUSHKU
XHEVAHIR DERMISHI
ERMIR DERMISHI
DENIS STASA
GJERGJI STAJA

